



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 660/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Sengul Mazreku kandidate për kuvendin komunal në Mamush nga subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) dega në Mamush, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Sengul Mazreku kandidate për kuvendin komunal në Mamush nga subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) dega në Mamush, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 13:35, ka pranuar një ankesë nga Kaqusha Kastrati kandidate për kuvendin komunal në Mamush nga subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) dega në Mamush e cila dyshon për shkelje të numërimit të votave në qendrën e votimit 3201 në Mamush, sepse Sibel Mazreku nuk i ka votat e merituar. Parashtruesja e ankesës thekson se ajo ka pasur vota me tepër në Mamush, ndërsa në KQZ kur janë numëruar kanë dale më pak vota. E njëjta dyshon se në Fushe Kosove kanë manipuluar me votat e saja dhe të shume kandidatëve tjerë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrën e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli vlerësoi se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL Anr.660/2017 më datën 10.11.2017.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.